

KONTRATE SHITJE KUOTASH

Në Tiranë, sot me datë 28.10.2019, U lidh kjo kontrate nga palët:

SHITËSI:

ALBA INVEST s.r.l. shoqëri e të drejtës italiane me seli në Lavis (Treno) Itali në Rr. Matteotti nr. 36, e regjistruar në regjistrin e ndërmarrjeve të Trentos me nr. 01945420220, me kapital social social 10.000,00 EURO (dhjetëmijë euro), perfaqësuar me prokure të posaçme nr. Rep. 9123 të datës 15/10/2019 (bashkëlidhur me Vulën Apostile), nga Z. BRUNO LAURI i biri i Domenico dhe Caterina, lindur në Napoli më 19/09/1967 banues në Rr. "Caproni Maini" P 18 Arco provinca Trento, Itali, i pajisur me kartë identiteti italiane nr. AX0395757. ALBA INVEST s.r.l. është ortak i 85% të kuotave të shoqërisë AR EUROPROJECTS SHPK me vlerën 1.668.550,00 lek. EUROPROJECTS SHPK është shoqëri e së drejtës shqiptare me NIPT: K66725001V me seli ne Rruga "At Shtjefen Gjeçovi", nr. 15,

BLERËSI:

Z. GJON RADOVANI i biri i Nush dhe Suzana, lindur në Shkodër më 08/03/1961, banues në Shtutgart, Wachterstr 5/2, 70182 Gjermani. I pajisur me pasaportë gjermane nr. C86H1PJRM.

PALË E TRETË:

Z. RENIS TERSHANA i biri i Agim dhe Nevin, lindur në Tiranë më 23/09/1971, banues në Tiranë Rr. "Sh. Ishmi" nr. 17. I pajisur me kartë identiteti nr. 027887821 dhe nr. personal H10923040R. Ortak i 15% të kuotave të shoqërisë AR EUROPROJECTS SHPK me vlerën 294.450,00 lek.

Objekti i kontratës

Palët e mësipërme bien dakord për të bërë një kontratë shitje kuotash si më poshtë:

SHITËSI: ALBA INVEST s.r.l si ortak zotërues i një kuote me vlerën 1.668.550,00 lekë ose e 85% të kapitalit të shoqërisë "AR EUROPROJECTS SHPK", e cila është një shoqëri tregtare shqiptare e themeluar me datë 25/05/2006 dhe njohur e tillë nga QKB-ja sipas regjistrimit me datë 20.11.2015 me nr. NIPT K66725001V. Në bazë të marrëveshjeve të arritura me blerësin Z. Gjon Radovani i kalon këtij të fundit kuotën prej 17% të shoqërisë AR EUROPROJECTS SHPK, për një vlerë prej 333.710,00 lek (treqind e tridhjetë e tre mijë e shtatë qind e dhjetë lek). Vlera do paguhet nga ortaku i ri në një moment të dytë.

BLERËSI: Z. Gjon Radovani impenjohet:

- T'i dorëzojë përfaqësuesit të shoqërisë ALBA INVEST s.r.l, të gjithë dokumentacionin që zotëron për shoqërinë AR EUROPROJECTS SHPK.

- Ti dorëzojë përfaqësuesit të shoqërisë ALBA INVEST s.r.l, projektin e "Shopping Center", objekt që AR EUROPROJECTS SHPK po ndërton në qytetin e Shkodrës dhe që blerësi i posedon projektet në cilësinë e arkitektit projektues.
- Të heqë dorë nga çdo pretendim ndaj shoqërisë ALBA INVEST s.r.l ku ka qënë ortak me kuotën 20%.
- Të kryejë pagesën për kuotat e blera, 17% të shoqërisë AR EUROPROJECTS SHPK, për një vlerë prej 333.710,00 lek, në një moment të dytë kur të dëshirojë apo kur të vendoset nga asamblea e ortakëve të AR EUROPROJECTS SHPK.

PALA E TRETË: Z. Renis Tërshana deklaron se është dakord me sa më sipër dhe nuk ka asnjë pretendim apo mosmarrëveshje për kalimin e kuotave në masën 17% të shoqërisë AR EUROPROJECTS SHPK, për një vlerë prej 333.710,00 lek, nga ALBA INVEST s.r.l tek Z. Gjon Radovani. Duke hequr dorë nga e drejta e parablerjes të kuotave si ortak me 15% të kuotave me vlerën 294.450,00 lek të AR EUROPROJECTS SHPK.

Të ndryshme

Kuotat e reja të shoqërisë si pasojë e kësaj kontrate do të jenë:

1. 68% ose 1.334.840,00 lek ortakut të shumicës ALBA INVEST s.r.l.
2. 17% ose 333.710,00 lek ortakut të ri, z. GJON RADOVANI.
3. 15% ose 294.450,00 lek ortakut RENIS TERSHANA.

Shitësi deklaron dhe garanton se është i vetmi titullar i ligjshëm i kuotave që po transferohen nëpërmjet kësaj kontrate dhe se ato janë të lira nga çdo barrë apo pretendim tjetër ligjor. Kjo kontratë u hartua në katër ekzemplare me vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe dhe palet deklaruan se janë dakort me sa më sipër, dhe pasi e lexuan, e kuptuan, e nenshkruan regullisht.

SHITËSI:

ALBA INVEST s.r.l ortak i
AR EUROPROJECTS SHPK
Përfaqësuar me prokurë nga
BRUNO LAURI



BLERËSI:

Z. GJON RADOVANI



PALË E TRETË

Z. RENIS TERSHANA

